1. Kapitali aksionar themeltar i Shoqërisë do të jetë EUR 3,000,000 (tre milion euro). Kapitali i shoqërisë do të ndahet në 1000 (një mijë) aksione të nënshkruara, me vlerë nominale prej EUR 3,000 (tre mijë euro) selici. Këto vlera do të konvertohen në Lekë Shqiptar ("ALL") sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Kapitali përbëhet nga kontribute monetare.
3. Çdo aksion ka të drejtën e një vote në Shoqëri.
4. Aksionet janë të shprehura në vlerë nominale.
5. Aksionet mund të transferohen në përputhje me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
6. Aksionet e nënshkruara të kontribuara në para duhet të shlyhen para regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të paktën në shumën e barabartë me një të katërtën e vlerës nominale të tyre. Shumat e mbetura paguhen në një ose më shumë këste brenda afateve të përcaktuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Aksionet e nënshkruara me kontributet në natyrë duhet të shlyhen plotësisht para regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
7. Këshilli Mbikëqyrës mundet në çdo kohë të njoftojë dhe të kërkojë nga aksionarët të paguajnë shumat e papaguara në lidhje aksionet e nënshkruara por tëpashlyera plotësisht. Njoftimi me shkrim për pagesën duhet të specifikojë kohën dhe vendin e pagesës dhe mund të lejojë që kontributet e papaguara të paguhen me këste.
8. Nëse aksioneri që merr njoftimin për pagesë të parashikuar në pikën (7) më sipër, nuk kryen pagesat sipas njoftimit, aksionari i përmendur do të jetë i detyruar të paguajë kamatëvonesë me një normë vjetore prej 4% (katër përqind) të shumës së papaguar duke filluar nga data e fundit e përcaktuar në njoftimin për ekzekutimin e pagesës.
9. Nëse aksionari që merr njoftimin për të kryer pagesën e parashikuar në pikën (8) më sipër, nuk kryen pagesën sipas njoftimit, Këshilli Mbikëqyrës dërgon një njoftimit paraprak me shkrim aksionarit të lartpërmendur, me anë të cilit mundëson afatin prej 30 ditë pune për kryerjen e pagesës së detyrimeve të papaguara dhe interesat e përlllogaritura mbi pagesat e vonuara. Ky njoftim duhet të përfshijë kohën dhe vendin e pagesave që duhet të bëhen dhe gjithashtu duhet të përfshijë një deklaratë që vërteton se në rast të mos pagesës së shumave të kërkuara do të zbatohen dispozitat e pikës 2 dhe 3 të nenit 124 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.



10. Nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të nenit 124 të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, aksionet e papaguara mund të anulohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe anulimi do të përfshijë të gjitha dividendët ose çdo shumë tjetër që duhet paguar ndaj aksionarëve në fjalë në lidhje me aksionet e papaguara.
11. Anulimi i aksioneve të përmendura në pikën (10) më sipër do të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë në përputhje me nenin 186 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Neni 6

Rritja dhe zvogëlimi kapitalit

1. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit mund të realizohet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve në bazë të Raportit të Këshillit të Mbikëqyrësve dhe/ose Administratorëve.
2. Kapitali mund të rritet ose zvogëlohet dhe të krijojë ndryshime në pronësinë e aksioneve sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
3. Në rast të rritjes së kapitalit, aksionarët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve të reja në përpjesëtim me numrin e aksioneve që mbajnë (e drejta e parablerjes).
4. Në rast të rritjes së kapitalit me kontribute në natyrë, një vlerësues ekspert caktohet me vendim të gjykatës së rrethit në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Rritja e kapitalit duhet të përfundojë brenda afatit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe në çdo rast brenda 5 (pesë) viteve nga data kur Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, mori një vendim të tillë.
5. Në rast të rritjes së kapitalit, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori duhet të verifikojnë depozitim të kapitalit, në përputhje me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme.
6. Në rast të zvogëlimit të kapitalit, Këshilli Mbikëqyrës dhe/ose Administratori/ët duhet të paraqesin në Asamblesë e Aksionarëve një raport që paraqet rrethanat që cojnë në zvogëlimin e kapitalit. Në çdo rast zvogëlimit i kapitalit nuk do të jetë më i vogël se pragu minimal i parashikuar në ligjet në fuqi.

Neni 7

Transferimi i aksioneve të Shoqërisë

1. Transferimi i aksioneve bëhet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
2. Kur një aksionar dëshiron të transferojë aksionet e tij pjesërisht ose tërësisht, aksionari është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin Mbikëqyrës, duke specifikuar vlerën e aksioneve, në mënyrë që pjesa tjetër e aksionarëve të mund të ushtrojë të drejtën e tyre të parablerjes. Këshilli Mbikëqyrës njofton me shkrim aksionarët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës nga data kur ka marrë njoftimin për transferimin e aksioneve nga aksioneri transferues.
3. Pjesa tjetër e aksionerëve duhet të njoftojë Këshillin Mbikëqyrës nëse ata do të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes ose jo, brenda 3 muajve nga data e njoftimit nga Këshilli Mbikëqyrës.

4. Kur një aksionar dëshiron të blejë aksionet në shitje, ai do të blejë vetëm atë numër aksionesh në përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotëron në momentin e njoftimit sipas pikës 2 të këtij neni.
5. Transferimi i aksioneve do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk ka asnjë efekt ligjor në rast të mosrespektimit të ndonjë prej dispozitave të këtij neni.

Neni 8

Struktura dhe Organet e Shoqërisë

1. Shoqëria është e organizuar dhe funksionon si shoqëri aksionare me sipas strukturës/modelit me dy-nivele.
2. Organet e Shoqërisë janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve;
 - b) Këshilli Mbikëqyrës;
 - c) Administratorët.

Neni 9

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të ushtrojë të gjitha kompetencat e përcaktuara në Ligjin mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe vendos për çështjet në vijim:
 - a) Ndryshimet e Statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Miratimin e skemës së shpërblimit për personat e përmendur në shkronjat "b" dhe "c" të kësaj klauzole;
 - e) Përcaktimi i politikave tregtare;
 - f) Miratimin e pasqyrave vjetore financiare dhe raportet e performancës së veprimtarisë;
 - g) Shpërndarja e fitimeve vjetore;
 - h) Rritja ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar;
 - i) Ndarjen dhe anulimin aksioneve;
 - j) Ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksionet e llojeve të kategorive të veçanta;
 - k) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjyqet e filluara kundër anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës ose Administratorëve;
 - l) Riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë;
 - m) Miratimi i rregullave të procedurës të mbledhjeve të veta;
 - n) Çështje të tjera të përcaktuara qartësisht në ligjet e aplikueshme.
 - o) Çështje të tjera, të cilat pasi janë vendosur, janë të detyrueshme për organet e tjera të Shoqërisë, deri në atë masë që vendimet e tilla nuk bien në kundërshtim me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ose ndonjë ligj tjetër në fuqi.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos në bazë të një shumice të thjeshtë vetëm nëse aksionarët (ose përfaqësuesit e tyre) që përfaqësojnë 30 (tridhjetë) përqind ose më shumë të

aksioneveteregjistruara me të drejtë vote janë të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Nëse nuk është plotësuar kuorumi, Mbledhja do të shtyhet jo më vonë se 30 ditë me të njëjtat çështje të rendit të ditës.

3. Për çështjet që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë vendimet vetëm nëse në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme marrin pjesë aksionarët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e aksioneve të regjistruara me të drejtë vote. Nëse nuk është plotësuar kuorumi, Mbledhja do të shtyhet jo më vonë se 30 ditë me të njëjtat çështje të rendit të ditës.
4. Cdo vendimmarrje në lidhje me ndryshimet në Statut, zmadhimin/zvoglimin i kapitalit dhe shpërndarja e fitimit, riorganizimin ose shpërbërjen e Shoqërisë miratohen me votat që përfaqësojnë tre të katërtat e numrit të përgjithshëm të aksioneve të regjistruara (shumicë e kualifikuar). Të gjitha çështjet e tjera mund të aprovohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e thjeshtë të votave të aksionarëve, të pranishëm në mbledhje.
5. Një aksioner mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një person i tretë i autorizuar. Administratorët dhe anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrësve nuk mund të përfaqësojnë aksionarë të tjerë në Asamblenë e Përgjithshme. Aksionarët që nuk janë fizikisht të pranishëm në mbledhje mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, duke përfshirë mjetet elektronike, nëse është i garantuar identifikimi i anëtarëve.

Neni 10

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, sipas Statutit dhe sa herë do të jetë e nevojshme me qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme behet së paku një herë në vit dhe jo më vonë se 6 muaj nga fundi i vitit fiskal/ushtrimor me qëllim diskutimin, vlerësimin dhe miratimin e pasqyrave financiare të vitit të kaluar fiskal/ushtrimor.
2. Asambleja e Përgjithshme mblidhet nga Administratori (Administratorët) dhe në rastet e parashikuara nga ligji, nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose aksionarët që zotërojnë së paku 5 për qind të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. Aksionarët duhet të njoftohen me e-mail ose me postë të regjistruar për mbledhjen dhe rendin e ditës së paku 21 ditë para mbledhjes.
3. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet në qoftë se bilanci vjetor ose te pasqyrat e përkohshme financiare tregojnë ose parashikojnë qartë se humbjet arrijnë shumën e barabartë prej 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ose kur aktivet e Shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet e saj për 3 muajt e ardhshëm.
4. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet kur ka një propozim nga Shoqëria për të shitur ose tjetërsuar asetet që arrijnë një vlerë shumë se 5% të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara më të fundit. Në rastet e parashikuara në këtë klauzolë dhe në pikën 3 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme paraqet një raport të ekspertit kontabël të autorizuar, përveç nëse blerjet janë pjesë e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë dhe kryhen në kushte normale të tregut.
5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në selinë e Shoqërisë ose në ndonjë vend tjetër, brenda dhe jashtë vendit, ku aksionarët e vlerësojnë dhe bien dakord. Asambleja e Përgjithshme mblidhet sipas ligjit.

Neni 11
Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga një minimum prej (3) deri në (7) Anëtarëve të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Shumica e anëtarëve të saj duhet të jenë të pavarur në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë administratorë të Shoqërisë.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ushtrojnë funksionet e tyre për 3 (tre) vjet nga data e emërimit.
4. Personat e mëposhtëm (individë) janë - në kohën e miratimit të Statuti - anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, të emëruar për një periudhë tre vjeçare, deri në zëvendësimin e tyre me anë të vendindimit të ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme:
 - I. **Z. James Lewis**, shtetas britanik, lindur me 16 mars 1965, me pasaportë nr. 517701966 ("Kryetari"); dhe
 - II. **Z. Arben Kashari**, shtetas shqiptar, lindur me 01.02.1977, me letërnjoftim nr. 028791831; dhe
 - III. **Z. Paul Hoeglinger**, shtetas austriak, lindur në Linz, Austri me 24.03.1978, mbajtës i pasaportës nr. U1714927.

Neni 12
Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh midis anëtarëve të tij një Kryetar dhe një Zëvendëskryetar, i cili është përgjegjës për thirrjen e Mbledhjes së Këshillit dhe për drejtimin e diskutimeve.
2. Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë si sekretar një nga anëtarët e tij ose çdo person tjetër.
3. Në rast të mungesës së Kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga Zëvendëskryetari.

Neni 13
Të Drejtat dhe Detyrimet e Këshillit Mbikëqyrës

- 1 Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
 - a. Të kontrollojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë nga administratori;
 - b. Të përgatisë, sipas kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave nën kompetencat e kësaj të fundit, t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme marrjen e vendimeve të nevojshme dhe të zbatojë ose të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.
 - c. Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme kurdo që është e nevojshme për interesin e Shoqërisë.
 - d. Të miratojë rregulla dhe rregullore të brendshme, në bazë të ligjeve dhe këtij Statuti për çështje të ndryshme që lidhen me menaxhimin e Shoqërisë, aktivitetin, etj.
 - e. Të sigurojë respektimin e ligjeve dhe standarteve të kontabilitetit nga Shoqëria ;
 - f. Të rishikojë dhe mbikëqyrë librat kontabël, dokumentet dhe asetet e Shoqërisë;
 - g. Të sigurojë që aktivitetet dhe veprimtaritë e Shoqërisë janë në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
 - h. Të kryejë në çdo kohë të gjitha verifikimet dhe kontrollet që konsiderohen të përshtatshme për përmbushjen e detyrave të tij.



- i. Të mbikëqyrë veprimtarinë e Administratorëve, të miratojë strukturën organizative dhe buxhetin e Shoqërisë, të përcaktojë kompetencat e Administratorëve, të miratojë marrëveshjet që kërkojnë autorizimin e tij paraprak në pajtim me ligjin në fuqi, këtë Statut, dhe Rregulloret për veprimtarinë e Administratorëve të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës.
 - j. Të sigurojë që pasqyrat vjetore financiare, raportet e performancës së biznesit dhe detyrimet e tjera të raportimit dhe publikimit të kërkuara me ligj ose me nenet e Shoqatës, të kryhen me saktësi nga Administratorët. Këto dokumente miratohen dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'u dorëzuar në Asamblenë e Përgjithshme, të shoqëruara me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe përshkrimin e mbikëqyrjes së menaxhmentit gjatë vitit financiar.
 - k. Të sigurojë që auditimi i librave dhe regjistrimeve të kontabilitetit të kryhet së paku një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe i pavarur dhe që raporti i auditimit i adresuar Asamblesë së Përgjithshme të përdoret për të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorëve, raporti i Këshillit Mbikëqyrës të përmendur në shkronjën "i" të këtij neni, gjithashtu përmban mendimin për raportin e auditimit;
 - l. Të emërojë dhe shkarkojë Administratorët që i pasojnë Administratorët të përmendur në pikën 3 të nenit 15 të këtij ligji dhe të përcaktojë shpërblimin e tyre;
 - m. Të kryejë akte të tjera të përcaktuara në ligjin në fuqi dhe në këtë Statut.
2. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 10 të këtij Statuti, Këshilli Mbikëqyrës menjëherë thërret Asamblenë e Përgjithshme, me qëllim që të shqyrtojë nëse Shoqëria duhet të shpërbëhet ose të marrë masa të tjera të nevojshme dhe të përshtatshme.
 3. Këshilli Mbikëqyrës autorizon marrëveshjet e përmendura në nenin 17 të këtij Statuti.

Neni 14

Mbledhjet dhe Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Me kërkesë të Kryetarit, ose në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit, Këshilli Mbikëqyrës mbledhet sa herë që interesat e Shoqërisë e kërkojnë, por zakonisht të paktën katër herë në vit (një herë në çdo tremujor gjatë çdo vit kontabël), me kërkesë të Kryetarit ose, në mungesë të tij, të Zëvendëskryetarit.
2. Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Mbikëqyrës brenda një afati të arsyeshëm kur Administratori ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, me kërkesë të motivuar, i drejtohet Kryesuesit për t'u takuar. Njoftimet për mbledhjen do të përmendin pikat kryesore të rendit të ditës. Në rast se Kryetari, ose në mungesë të tij, Zëvendëskryetari nuk arrin të thërrasë Këshillin Mbikëqyrës brenda dhjetë ditëve nga marrja e kërkesës si më sipër, kërkuesi mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duke përcaktuar çështjet e rendit të ditës të mbledhjes.
3. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të mbahen brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit, siç tregohet në njoftim, dhe mund të kryhen edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës ose me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen në mënyrë të duhur dhe marrin pjesë në diskutime dhe marrin pjesë aktivisht në to. Nëse plotësohen këto kushte, takimi i Këshillit Mbikëqyrës konsiderohet

i mbajtur në vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të hartohen dhe nënshkruen procesverbalet.

4. Procesverbali mbahen nga sekretari i mbledhjes dhe nënshkruhen nga ai/ajo dhe Kryetari, ose në mungesë të tij, nga Zëvendëskryetari. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë.
5. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës bëhen me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të tij të pranishëm dhe në rast barazimi, vota e Kryetarit mbizotëron, ose në mungesë të tij, do të mbizotërojë vota e Zëvendëskryetarit.
6. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë mund të verifikojnë procesverbalin.

Neni 15
Administratorët

1. Shoqëria administrohet nga një Administrator ose më shumë se një Administrator, i emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës në përputhje me kufizimet e përshtatshme të parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.
2. Administratori/ët kryen të gjitha veprimet administrative të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë.
3. Personi(at) e mëposhtëm janë Administratorët e parë të Shoqërisë në kohën e miratimit të këtij Statuti dhe zgjidhen dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve për një mandat trevjeçar:
 - I. **Z. Mark John Tutt**, shtetas britanik, lindur në Uckfield, me 2 Mars 1969, mbajtës i pasaportës nr. 513226581; dhe
 - II. **Z. Gazmir Spahija**, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër, Shqipëri, me 28.04.1979, me numër letërnjoftimi 033843392.
4. Administratorët pasues emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës me shumicë prej jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të tij të pranishëm në mbledhje.
5. Administratori nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.
6. Administratori mund të shkarkohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës në çdo kohë.
7. Administratori emërohet për një mandat 3 (tre) vjet, ka të drejtë të riemërohet.
8. Në rast se Shoqëria administrohet nga më shumë se një Administrator, ata do të administrojnë Shoqërinë bashkërisht. Nëse Shoqëria administrohet dhe menaxhohet nga më shumë se një Administrator, rregullat dhe rregulloret për administrimin dhe përfaqësimin do të përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
9. Këshilli Mbikëqyrës mundet, ose përmes akteve të brendshme që rregullojnë funksionet e administratorëve, ose përmes një vendimi të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, të kufizojnë kompetencat e administratorëve; kufizimet e tilla, megjithatë, nuk kanë efekt në lidhje me palët e treta, përveç nëse regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
10. Në rastin e një vendi bosh për Administratorin për shkak të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit, Këshilli Mbikëqyrës menjëherë vazhdon me zëvendësimin e tij / saj.

Neni 16



Të drejtat dhe kompetencat e administratorit

1. Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:
 - a) Të kryejë të gjitha aktet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
 - b) Të përfaqësojë Shoqërinë;
 - c) Të sigurojë regjistrime të sakta dhe të rregullta dhe mbajtjen e librave kontabël të Shoqërisë;
 - d) Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e performancës dhe t'i paraqesë ato për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të cilat pastaj do të dorëzohen për miratim përpara Asamblesë së Përgjithshme ;
 - e) Të krijojë një sistem monitorimi dhe njoftimi të hershëm për rrethanat që rrezikojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - f) Të kryejë regjistrimet dhe publikimet e kërkuara të të dhënave të Shoqërisë, sipas dispozitave të Ligjit mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, të ndryshuar dhe/ose ligje të tjera;
 - g) T'i raportojë Këshillit Mbikëqyrës lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive të rëndësishme të veçantë, për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - h) Të japë udhëzime për zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - i) Të miratojë marrjen e detyrimeve në vlerë më të madhe se 5% të aktiveve të Shoqërisë, që rezultojnë nga pasqyrat financiare më të fundit (të certifikuara) për nënshkrimin e huave ose për lëshimin e obligacioneve të Shoqërisë ose instrumente të tjera të borxhit;
 - j) Të vendosë bashkëpunime afatgjata tregtare dhe propozime të politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose grupeve të reja;
 - k) Të delegojë dhe emërojë një përfaqësues për kryerjen e detyrave të vecanta ose kategorive të vecanta të detyrave, brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë Administratorit.
 - l) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligjin në fuqi dhe në këtë Statut.
2. Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës sipas ligjit nuk mund t'i delegohen administratorit.
3. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 10 të Statutit, Administratori do të informojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës.
4. Detajet mbi fuqinë për të nënshkruar në emër të Shoqërisë do të përcaktohen në rregullat mbi kompetencat nënshkruese të cilat miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
5. Me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës, Administratori kryen veprimet e mëposhtme dhe merr masat e mëposhtme:
 - a) Vendos dhe kryen investimet dhe transaksionet financiare për vitin financiar, si dhe ndërmerr masa të tjera që kërkojnë ndryshime në buxhetin fillestar të Shoqërisë;
 - b) Blen, disponon, shkëmben, grumbullon dhe/ose shet prona, duke përfshirë pasurinë e patundshme;
 - c) Merr kredi afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata, ofron garanci kur ato tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë;
 - d) Negocion, përfundon dhe ndryshon çdo kontratë në shuma që tejkalojnë shumën e parave të përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës;
 - e) Kryen huamarrje nëpërmjet obligacioneve ose kredisë si dhe pranon detyrime për obligacione, hua dhe kredi që tejkalojnë një shumë të caktuar për raste të vecanta ose totalin për vitin fiskal;
 - f) Investon në shuma që tejkalojnë një shumë të caktuar për raste të vecanta ose totalin për vitin fiskal;

- g) Përcakton parimet e përgjithshme të politikës së biznesit.
6. Kufijtë e vendosura nga pikat (c), (d), (e), (f) më lart në këtë nen, përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës me rregullore/vendim të brendshëm. Nëse nuk përcaktohen kufizime, të gjitha transaksionet e parashikuara në pikat (c), (d), (e), (f) më lartë në këtë nen, do të kërkojnë miratimin paraprak të Këshillit Mbikëqyrës.
7. Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë për transaksione dhe veprime shtesë të cilat do t'i nënshtrohen miratimit të tij paraprak.
8. Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij që ai e gjykon të përshtatshme për një ose disa persona të tjerë që ushtrojnë funksione teknike në menaxhimin e Shoqërisë.

Neni 17

Marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe Administratorit ose anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës

1. Çdo marrëveshje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë ndërmjet Shoqërisë dhe administratorit ose anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, i nënshtrohet autorizimit paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës. Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm do të dorëzohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Miratimi i përmendur në pikën e këtij neni jepet gjithashtu për çdo kontratë tjetër që lidh Shoqëria me një palë të tretë, e cila është në një marrëdhënie personale ose financiare me Administratorin ose anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës, ose palët e treta, marrëdhëniet e të cilëve me personat e lartpërmendur janë të tilla që të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e Shoqërisë. Ligji mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare përcakton personat që mund të kenë një ose më shumë nga interesat e lartpërmendura me Administratorin ose anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 18

Viti financiar

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 19

Të drejtat për të lëshuar çeqe dhe urdhërpagesa.

1. Lëshimi i çeqeve dhe urdhërpagesave bëhet sipas listës së miratuar me vendim të Administratorit.
2. Vendimi i administratorit i komunikohet bankës dhe përbën mandatin/miratimin e Shoqërisë për Bankën. Mandati/miratimi i Shoqërisë për bankën mund të modifikohet me vendim të Administratorit.

Neni 20

Llogaritë vjetore

1. Shoqëria mbanaktivet dhe veprintaritëe sajakontabilisht të rregullta në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
2. Në fund të vitit financiar, Administratori përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e performancës së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe ia dorëzon Këshillit Mbikëqyrës për miratim, të cilat më pas dorëzohen në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

Neni 21

Rezultati i ushtrimit financiar dhe shpërndarjes së fitimit

1. Asambleja e Përgjithshme vendos për destinimin e fitimeve të Shoqërisë.
2. Të ardhurat vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjet në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
3. Nga fitimi (pas tatimit) i realizuar gjatë vitit financiar të mëparshëm, hiq shpenzimet, Shoqëria do të kalojë në rezervën ligjore së paku 5% të kësaj shume, derisa shuma e lartpërmendur të jetë 10% (dhjetë përqind) e regjistruar kapitalit të Shoqërisë.
4. Shoqëria llogarit dhe shpërndan dividendët tek aksionarët vetëm pasi mbi fitimet vjetore janë zbritur shumat e specifikuar për rezervën ligjore.
5. Dividendi shpërndahet ndërmjet aksionarëve në proporcion me shumën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnëaksionet e secilit aksionar.
6. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që dividendët ose të ardhurat/fitimet vjetore të mos shpërndahen ose që fitimet vjetore të mos u paguhen aksionarëve, por që këto shuma të përdoren për qëllime të tjera.
7. Në rast se viti financiar rezulton me humbje, humbja kalohet dhe përfshihet në fitimet e vitit vijues deri në shuarjen e saj.

Neni 23

Zgjidha e mosmarrëveshjeve

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet aksionarëve që lindin nga ky Statutdo të arrihet nëpërmjet negociatave. Në rast se nuk arrihet ndonjë zgjidhje, organi që palët do t'udrejtohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24

Te pergjithshme

1. Nëse një dispozitë e këtij Statuti është ose bëhet e padobishme, e pazbatueshme, e pavlefshme ose e paekzekutueshme, dispozitat e tjera do të mbeten efektive dhe të zbatueshme.
2. Ky Statut i Shoqërisë hartohet në gjuhën angleze, bashkëngjitur së cilit gjendetpërkthimi në gjuhën shqipe. Për çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga zbatimi dhe/ose interpretimi i këtij akti, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

3. Për çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
4. Shoqëria mund të njoftojë një aksioner personalisht ose me një letër të dërguar në adresën e regjistruar për aksionarin në fjalë ose në adresën e tij/saj të e-mailit.

Datë 2 Maj 2019

SHARD CAPITAL PARTNERS LLP

Përfaqësuar nga:

(nënshkrimi)

James Lewis – Partner Drejtues

Vula: *Shard Capital Partners LLP*
20 Fenchurch Street
London EC3M 3BY
Mreteria e Bashkuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 1636 Rep

VËRTETIM
PËRKTHIMI

Sot më datë 31 Maj 2019 (dymije e nentembëdhjetë), përpara meje Noteres Publike Donika A. Gjini, anëtare e Dhomës së Noterisë Tirane, me adresë në Blv. Curri, u paraqit personalisht Erjon Çejku, dtl. 13.05.1989, lindur në Kukës e banues në Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me numer personal I90513075C, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili perktheu nga Gjuha Angleze ne Gjuhen Shqipe dokumentin: *Statuti I "Shard Capital Solutions" sh.a.* Perkthyesja me deklaroi nen pergjegjسية e saj se perkthimi eshte bere njesoj me origjinalin dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e saj ne dokument, ne perputhje me Ligjin.

REPUBLIC OF ALBANIA
CHAMBER OF NOTARIES TIRANA
Reg.No. 1636

CERTIFICATE
OF TRANSLATION

Today, on May 31 2019, (two thousand nineteen), in front of me Public Notary Donika A. Gjini, member of Notary's Chamber of Tirana, legally seated in Erjon Çejku, born on 13.05.1989 in Kukës and resident in Tirana, known by me with identity card with personal number I90513075C, major and with full capacity to act, who translate from English to Albanian the document: *Articles association of "Shard Capital Solutions" sh.a.* The translator declares under her full responsibility that the translation is a genuine and accurate translation and I, the public notary, finding this act in conformity with the law, do authenticate it.

NOTERE PUBLIKE/PUBLIC NOTARY

DONIKA GJINI

